



URDHËR

Nr. 134, Datë 01/12/2014

"Për

**shpalljen e procesit zgjedhor të parakohshëm për autoritetin drejtues të
Fakultetit të Muzikës në Universitetin e Arteve"**

Në bazë të të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve", miratuar me Vendim nr.1, date 17.01.2012, Vendimin nr.2, date 26.01.2012, të SA, Urdhërit nr.468, date 26.11.2014 të Ministres së Arsimit dhe Sportit, nenit 39 të Statutit të Universitetit të Arteve;

URDHËROJ

1. Shpalljen e ditës së fillimit të procesit zgjedhor të parakohshëm për drejtues të Fakultetit të Muzikës. Dita e fillimit të procesit zgjedhor për Dekanin e Fakultetit të Muzikës është data 01 dhjetor 2014.
2. Dita e votimit për Dekan të Fakultetit të Muzikës do të jetë 12.01.2015. Votimi fillon në orën 09.⁰⁰ dhe vazhdon deri në orën 15.⁰⁰.
3. Për organizimin e zgjedhjeve të parakohshme për Dekan të Fakultetit të Muzikës, të rifunksionojnë këto komisione:
 - a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i UART;
 - b. Komisioni i Zgjedhjeve të Fakultetit të Muzikës;
 - c. Komisioni i Ankesave;
4. Zgjedhjet organizohen dhe zhvillohen nën drejtimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të UART.

Përbërja e komisioneve, sipas pikës 3 të këtij urdhëri:

- a. KQZ i UART, sipas VSA nr. 3, datë 26.01.2012;
- b. KZ të FM, sipas VSA nr.4, datë 26.01.2012;
- c. Komisioni i Ankesave të UART, sipas VSA nr.5, datë 26.01.2012;


Kryetari i KQZI verifikon nëse në Komisionet e mësipërme ka mungesa anëtarësh. Plotësimi i tyre të bëhet sipas Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve".



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

5. KZ i FM, të vendoset në ambientet e Fakultetit të Muzikës.
6. Dekani në detyrë i FM, Kancelari i UART dhe Administratorja e Fakultetit të Muzikës, të mbështesin me bazën e nevojshme materiale Komisionet sipas pikës 3 të këtij Urdhri ;
7. Anëtarët e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve të UART, të Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Muzikës dhe të Komisionit të Ankesave, nuk mund të kandidojnë për Dekan të Fakultetit të Muzikës;
8. Listat e zgjedhësve përgatiten nën përgjegjësinë e Dekanit në detyrë të FM, K/Sekretares së FM në bashkëpunim me DBNJ, pranë Rektoratit të UART dhe ju dorëzohen KZFM jo më vonë se dhjetë ditë nga data e fillimit të procesit zgjedhor në Fakultetin e Muzikës. KZFM të afishojnë menjëherë listat paraprake të zgjedhësve në mjedise të dukshme të Fakultetit të Muzikës;
9. Kandidatët për Dekan të FM, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve", si dhe në Statutin e UART;
10. Qendra e votimit vendoset në ambjentet e Fakultetit të Muzikës, në Sallën "Çesk Zadeja";
11. Ky urdher të publikohet në faqen web të UART.
12. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Dekani i FM, Komisionet e përcaktuara në këtë urdhër, Kancelari i UART, si dhe gjithë strukturat e nevojshme në ndihmë të këtij procesi në FM.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE